



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008,” e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 2025, miratoi këtë:

Draft - V E N D I M

Për bartjen të THV 2023 dhe THV 2024 të pa shpenzuara gjatë vitit fiskal 2024 në shumë prej 103,237.06€ të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025

Neni 1

1.1. Komuna e Suharekës gjatë vitit 2024 i nuk i ka shpenzuar mjetet e THV-së 2023 dhe 2024 andaj jemi të obliguar që të bëjm bartjen e tyre mjeteve në shumë prej = **103,237.06€**.

1.2. Mjetet e grumbulluara si të pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2025 shuma prej **103,237.06€** janë paraqitur në tabelen e poshtëshenur sipas njësive buxhetore dhe kategorive ekonomike.

Tabela 1

Programet/nënprogramet	Mallra dhe Sherbime	Sherbime Komunale	Subvencion e dhe Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Zyra e Kryetarit (16012)	4,825.27	-	212.25	-	5,037.52€
Administrata dhe Përsonele (16312)	12,578.44	-	-	-	12,578.44€
Shërbimet Publike dhe emrgjente (18012)	-	24,100.00	-	7,436.59	31,536.59€
Buxhet dhe Financa (17512)	12,313.74	-	-	-	12,313.74€
Administrata e Arsimit (92060)	6,757.73	35,013.04	-	-	41,770.77€
TOTAL:	36,475.18	59,113.04	212.25	7,436.59	103,237.06€

Lista e projekteve kalitale për bartje nga viti 2023 dhe 2024 që do të bartet në vitin fiskal 2025 për shpenzim

Tabela 2.

Nr. Ren dor	EMRI I PROJEKTIT	FINANCIMI NGA BARTJA 2023/2024
1	55741-NDERTIMI I KULLËS SË DËSHMORVE NË DOBERDELAN	7,436.59
	Gjithsej: Shërbime Publike dhe Emergjencë - Infastruktuerë rrugore (18012)	7,436.59
	TOTALI KOMUNAL :	7,436.59 €

Arsyetim

Shuma prej **103,237.06€** duhet të bartet në programin e SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim dhe shpenzim, në këto programe buxhetore dhe projekte kapitale si pjesë e pa shpenzuar nga THV 2023 dhe 2024.

Mjetet e pa shpenzuara gjatë periudhave të cilat do shpërndahen sipas vendimit të Asamblesë Komunale në këto kategori ekonomike:

Në **“Mallra dhe sherbime”** shuma prej **36,475.18€** sipas Drejtorive konform tabelës 1

Në **“Sherbime komunale”** shuma prej **59,113.04 €** sipa Drejtorive konform tabelës 1

Në **“Subvencione dhe transfere”** shuma prej **212.25€** të zyra e kryetarit në :

Në kategorin e “Projekteve kapitale” shuma prej **7,436.59€**, Sherbimet Publike dhe Emergjencë.

Ndërtimi i kullës së dëshmorve në doberdelan, kodi i projektit (55741) shuma prej **7,436.59€** mjetet janë të grumbulluara nga shumë projekte të vitit 2023 dhe 2024 në shumën të vogël dhe si total do të paguhet projekti në fjalë pasi që kemi obligime të mbetura ndaj OE-punëkryesit për vitin 2025.

Për kategorit ekonomike “Mallta dhe sherbime,” shuma prej **36,475.18€**, të ndara në njësit buxhetore janë obligime të mbetura pa u paguar si pasojë e Vendimeve përmbarimore –të gjykatave për kompenzimin e pagave për punëtorët arsimor si obligim i ministrive të linjës e në ngarkesë të buxhetit komunal.

Kategoria e “shpenzimeve komunale” shuma prej **59,113.04€**, të ndara në njësit buxhetore, janë obligime të cilat duhet paguar pasi që Vendimet përmbarimore –të gjykatave kanë prekur edhe këtë kategori ekonomike.

Kategoria “Subvencione dhe transfere” në shumën prej **212.25€**, pjesë e mbetur që nuk do të ndryshojmë strukturën e shpenzimeve konform ligjit të buxhetit për vitin 2025.

Të gjitha shumat e cekura më lartë sipas kategorive ekonomike dhe njësitve buxhetore nuk e prish strukturën e shpenzimeve sipas Ligjit Nr.08/L-332 të buxhetit mbi ndarjet buxhetore të Buxhetit të RKS për vitin 2025.

Neni 9 pika 5 dhe 6 e këtij ligji thuhet se bilancet e pasqyruara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2024 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2025 sipas autorizimeve të LMFPP-së .

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive.

Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi i njëjti do të shërbejë për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake pjesa e pa shpenzuar gjatë vitit fiskal 2023 dhe 2024, e të cilat do të barten alokohen në SIMFK dhe shpenzohen në vitin fiskal 2025.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI